

GRANTS AND SUBSIDIES (DIRECT PAYMENTS) TO AGRICULTURE AND RURAL DEVELOPMENT IN KOSOVO

GRANTET DHE SUBVENCIONET (PAGESAT DIREKT) PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL NË KOSOVË

NEHAT VELIU*, MUJE GJONBALAJ**, EKREM GJOKAJ***

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural, KOSOVË

** Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, KOSOVË

*** Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural, KOSOVË

nehat.veliu@gmail.com

AKTET V, 3: 435-442, 2012

PERMBLEDHJE

Qëllimi kryesorë i këtij punimi ishte studimi i ndikimit të skemave mbështetëse (Grandeve për zhvillim dhe pagesave direkt) në zhvillimin rural dhe bujqësor në Kosovë. Punimi është bazuar në hulumtimin e efekteve nga përfituesit e granteve në fermat e sektorit të pemëtarisë dhe perimtarisë. Zgjedhja e mostrës është bërë në mënyrë të rastësishme. Janë intervistuar 80 përfitues të granteve në 5 zonat e Kosovës. Të dhënat fillimisht janë përpunuar në programin Excel, dhe me vonë janë transformuar në programin SPSS (Statistical Program Social Science). Hipoteza kryesore e punimit ishte se skemat e granteve kanë ndikuar në përmirësimin e rendimentit dhe të efikasitetit të ekonomisë së fermerëve përfitues të këtyre skemave në Kosovë. Për këtë arsye studimi ishte i fokusuar të japi përgjigje pyetjeve: pse, si dhe sa ndikojnë grantet në rritjen e rendimentit për hektar në nivelin e të ardhurave dhe aftësinë konkurruese të fermerëve? Rezultati përmbledhës tregon se shuma e financuar si mbështetje direkte për fermerët kishte ndikim të rëndësishëm në rendimentin e fermerëve përfitues të granteve. Vlera e Testit P-value=0.018 dhe Koeficienti i Regresionit 0.374, tregon për rëndësinë e këtij faktori në rendimentin të arritur nga fermerët. Disa nga faktorët tjerë ishin të një rëndësie shumë më të vogël.

Fjalë kyçe: Grantet, pagesa direkt, MBPZHR, Bashkësia Evropiane, analiza e regresionit..

SUMMARY

The purpose of this work was to study the impact of the support schemes (development grants) in agricultural and rural development in Kosova. The work is focused on evaluating the effects on the grant beneficiaries in fruit and vegetable farms. The sample was taken randomly. Interviews were conducted with 80 grant beneficiaries in five regions of Kosova. The data were first processed in Excel and then transformed on SPSS (Statistical Program Social Science). The main hypothesis of the work was that the grant schemes and the direct payments have had an impact on the improvement of the yield and the efficiency of the holdings of the beneficiary farmers from these schemes in Kosova. This study was focused on answering those questions: why, how and what is the impact of grants on yield increase per hectare, on the level of farmers' income and competitiveness? The final result shows that the amount funded as direct support for farmers had an important impact on the yield of farmers which have benefited grants. Test Value P-value=0.018 and the Regression Coefficient 0.374 show the importance of this factor on the yield achieved by farmers. Some of other factors were less important.

Key words: Grands, direct payments, MAFRD, European Union, regression analysis

1.HYRJE

Në Kosovë prodhimitaria bujqësore në përgjithësi është e ulët. Parcelizimi i madh i tokave, teknologjia e vjetruar, dhe konkurrenca jo e drejt ka bërë që Kosova mos të mund të konkurroj në treg më prodhimet e veta bujqësore:

Përveç kësaj sa i përket sektorit bujqësor dhe zhvillimit rural në Kosovë ka edhe vështirësi të tjera që vazhdojnë të ekzistojnë ende.

Nivel i ulët i efikasitetit të fermave, sipërfaqe mesatare të vogël, dhe prodhim bujqësor i fragmentuar, cilësi e ulët e prodhimeve bujqësore, përpunim minimal i prodhimeve bujqësore, të ardhura të ulëta në dispozicion të ekonomive shtëpiake etj. Përveç kësaj varësia nga Bujqësia shihet si burim kryesor i të ardhurave në zonat rurale, dhe standardi i jetesës është i ulët në zonat rurale. Gjithashtu për sa i përket infrastrukturës fizike dhe sociale, niveli i ulët i edukimit në mes të bujqve, mosha e shtyrë e bujqve etj.

Gjithashtu treguesit e bilancit tregtar flasin për dominim të madh të prodhimeve të importit në tregun bujqësor të Kosovës. Posaçërisht problematik për gjendjen e sektorit të bujqësisë përbën fakti i përballjes me një konkurrencë të ashpër nga importi, dhe pa ndihmën e duhur të shtetit dhe fondeve të BE-së, donatoreve të tjerë vështirë, se mund të ketë kushte të favorshme dhe konkurruese për fermerët në Kosovë. Megjithatë, bujqësia në Kosovë, vazhdon të jetë një nga degët më të rëndësishme dhe më premtuese për përmirësimin e treguesve makroekonomik. Në dallim nga shtetet e zhvilluara ku pjesëmarrja e bujqësisë në krijimin e BPV-së¹ merr pjesë me % të ulët, një shifrore, ajo në Kosovë, për një kohë të gjatë në dhjetëvjetëshin e fundit ishte mbi 20%, ndërsa tani llogaritet diku rreth 12% (ESK² 2009 faqe 13). Kjo pjesëmarrje e madhe e bujqësisë Kosovare në krijimin BPV-së nuk është rezultat i gjendjes së mirë në këtë degë, por edhe i gjendjes së rëndë ekonomike edhe në degët tjera të ekonomisë. Megjithëkëtë, roli i bujqësisë, në zhvillimin

ekonomik të Kosovës, konsiston në kushtet e favorshme që ka Kosova për zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht disa sektorëve të saj. Kosova sipas kushteve klimatike ndahet në dy zona bujqësore. Zona jugperëndimore, që përfshin Rrafshin e Dukagjinit dhe që mbulon rreth 43% të sipërfaqes së përgjithshme me klimë mediterane dhe të reshura vjetore prej 770 mm. Zona lindore që përfshin rrafshin e Kosovës dhe Anamoravës me sistemin Ibër-Lepenc, ka klimë kontinentale dhe reshje vjetore prej 600 mm, pra kultivimi i kulturave intensive bujqësore varet shumë nga ujitja. Popullsia e Kosovës llogaritet të jetë në mes 2 dhe 2.2 milionë banorë. Personat e moshës në mes 15 dhe 64 vjeç, që përafërsisht cakton kufijtë e potencialit të fuqisë punëtore në dispozicion në Kosovë, në vitin 2008 është 64.2% (ESK 2009c, faqe 11). Kosova ka një popullsi relativisht të re, me pothuajse një të tretën e popullsisë nën 15 vjeçare dhe 7.1 % e popullsisë mbi moshën 65 vjeçare, ndërsa popullsia bujqësore llogaritet të jetë mbi 60%. Edhe në këtë kategori, afër 55% i takon grup-moshës 15-49 vjeç (ESK 2009 b, faqe 15). Bujqësia e Kosovës pra është sektor në konsolidim i cili do të ndikoj në përmirësimin e kualitetit të jetesës në vendbanimet rurale dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

Duke e ditur këtë fakt Qeveria e Kosovës ka treguar përkushtimin e saj për krijimin e parimeve të ekonomisë së qëndrueshme të tregut dhe ka qenë e vendosur që përmes granteve për zhvillim³ dhe Pagesave direkt⁴ të

³ Në literaturë hasen definicione të ndryshme sa u përket granteve për zhvillim mirëpo kuptimi i tyre në të shumtën e rasteve është i njëjte. Grandi për zhvillim është ofrimi i përkrahjes financiare për projekte intensive me bashkëfinancim, ku pjesëmarrja në bashkëfinancim mund të jetë në përqindje të ndryshme varësisht nga qëllimi dhe sasia e mjeteve në dispozicion. Po e marrim një shembull gjatë vitit 2010 MBPZHR (Ministria e bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural) ka ofruar grante të ndryshme në sektorin e perimekulturës, pemëtarisë, mekanizim bujqësor etj, ku pjesëmarrja e bashkëfinancimit ka qenë 50:50 kurse të masa përkrahja për strategjitë e zhvillimit të komunitetit lokal (GLV-të) përkrahja e bashkëfinancimit ka qenë 70:30% me tendencë të rritjes edhe të mëturjesme të mbulimit të financimit nga ana e MBPZHR për vitet në vijim.

¹ BPV- Bruto prodhimi vendor

² ESK-Enti i statistikave të Kosovës

mbështet fermerët përmes skemave të qëndrueshme financiare.

Përmes këtij studimi jemi përpjekur që të tregojmë nëse zbatimi i granteve dhe subvencioneve ka ndikuar në përmirësimin e rendimentit të fermerët përfitues të këtyre skemave mbështetëse. Për këtë arsye ka qenë shumë më rendësi edhe ngritja e pyetjeve kryesore të cilave jemi përpjekur për t'ju dhënë përgjigje :

- A ndikojnë grandet për zhvillim në rritjen e rendimentit ?
- Sa ndikojnë grandet në rritjen e rendimentit për ha ?
- Sa ndikojnë grantet në nivelin e të ardhurave dhe aftësinë konkurruese të fermerëve?

2. HISTORIKU I GRANDEVE PËR ZHVILLIM DHE PAGESAVE DIREKT

Subvencionet paraqesin të ardhurat e ndryshme , të cilat i jep vendi apo shteti, dhe donatorët tjerë për një produkt të caktuar më të cilën mundësojnë prodhimin dhe përpunimin më të mirë të produktit (Ahner, and Scheele, 2000). Për herë të parë në lidhje me subvencionet janë bërë bisedimet në Tokio (Kryeqyteti i Japonisë) ku ka rrjedhë një marrëveshje e veçantë në lidhje me subvencionet. Në marrëveshjen e Tokios (12-14 shtator 1973) është bërë përpjekje që të konstatohen kufizimet me subvencionet eksportuese në mënyre që në radhë të parë të formulohen kriteret e përcaktimit se a janë në

rastin konkret palët kontraktuese të cenuara në program të subvencioneve eksportuese dhe a janë përcaktuar mjetet të cilat janë në dispozicion të shteteve të cilat kanë përjetuar cenimin me programin e subvencioneve të shtetit tjetër. Megjithatë marrëveshjen e Tokios e kanë aprovuar pak shtete. Për subvencionet përsëri është diskutuar gjatë bisedimeve në Uruguai. Në realitet çështje kryesore e bisedimeve të Uruguait kanë qenë subvencionet. Rezultati i bisedimeve të Uruguait kanë qenë dy marrëveshje themelore me rregulla të cilat janë dukshëm me të qarta (Adrian, K. 2000). Bisedimet përcaktuan elementet vijuese të cilat duhet të eksitojnë në lidhje me nocionin e subvencioneve:

- Subvencionet paraqiten në trajte të kontributit të caktuar financiar.
- Prodhuesi i produkteve bujqësore me të vërtet ka pasur dobi të caktuar nga subvencionet.

Që nga vitet e tridhjetë Shtetet e Bashkuara dhe vendet e Evropës i kanë ndihmuar fermerët me fonde shtetërore. Këto politika u zbatuan si pasojë e mungesave ushqimore, fatkeqësive natyrore dhe paqëndrueshmërisë së tregjeve. Synimi i këtyre subvencioneve ishte të rritej prodhimi, të garantohej një standard i përshtatshëm jetese për fermerët, të arrihej qëndrueshmëri e tregut, të sigurohej furnizimi i rregullt me ushqime si edhe çmime të arsyeshme për konsumatorët (Brenton and Nunez Ferrer, 2000).

Aktualisht, ndihma financiare për fermerët amerikanë ka arritur nivelet më të larta, kurse Bashkimi Evropian shpenzon rreth gjysmën e buxhetit për programin e ndihmave për fermerët. Ndihma për fermerët merr formë të ndryshme, varësisht nga politika e çmimeve të prodhimeve bujqësore në treg, deri tek kompensimi i drejtpërdrejtë i fermerëve për prodhime të caktuara (Canali, 2005)..

Qeveritë mund të sigurojnë kredi eksporti, duke u krijuar mundësinë fermerëve nga vende të pasura, me njësi monetare të qëndrueshme dhe mallra me çmime relativisht të larta, t'i shesin prodhimet e tyre në tregjet botërore, me çmime më të ulëta dhe më konkurruese. Mirëpo, kritikët vlerësojnë se kjo ndihmë jo vetëm që

⁴ Për dallim nga grandet pagesat direkt u jepen fermerëve për njësi (copë, koke ha etj) Thëne ndryshe kjo formë e përkrahjes bëhet 100% të shumës se parapare dhe përfituesit përveç kriterëve të parapare si p.sh numri i krerëve ,sipërfaqja në ha etj, nuk janë te obliguar të participojne me mjete te veta . Ne praktike ekzistojnë forma të ndryshme të pagesave direkt, sidomos në shumicën e vendeve të BE-se ende janë ne funksion edhe pagesat e kombinuara (Decouple payment) të cilat epen pjesërisht për kokë apo për sipërfaqe dhe pjesërisht për njësi të prodhimit.

përbën një barrë për taksapaguesit në vendet e zhvilluara, por subvencionet i lejojnë fermerët amerikanë dhe evropianë t'i shesin prodhimet e tyre në tregjet botërore me një çmim më të ulët se kostoja reale e mallit. Kjo e bën të pamundur për prodhimet lokale të konkurrojnë në treg, dhe si pasojë vendeve në zhvillim u mohohet një mjet shumë i rëndësishëm për zhvillim ekonomik.

PPB(Politikat e përbashkëta bujqësore) përfshin një varg rregullash dhe mekanizmash që rregullojnë prodhimin, tregtinë dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore në BE me vëmendje të përqendruar në zhvillimin rural. Objektivat e kryesore të PPB-së janë:

- Sigurimi i prodhimit të ushqimit për popullsinë dhe sigurimi i vetëmjaftueshmërisë në prodhimet bujqësore.
- Shtimi i produktivitetit bujqësor përmes promovimit të përparimit teknologjik.
- Sigurimi i një standardi të drejtë të jetesës për fermerët.
- Çmime të stabilizuara dhe të drejta të ushqimit për konsumatorët. (Fischler, 2001)

Reforma Fischler 2003 ishte - Përbushja e mjetit të ndër-përputhshmërisë dhe Kushtit të Bujqësisë dhe Mjedisit të Mirë Decoupling i pagesave direkt, "liria" në ferma dhe për të paraqitur risi ne fermë. Ai formoi një bujqësi shumë-funksionesh, me një funksion social-mjedisor-dhe mbrojtës (Swinnen, and Johan 2001).

Përkufizimi OECD(Organizata ekonomike për bashkëpunim dhe zhvillim) – 150 banorë/km²

Grandet dhe subvencionet në Kosovë kanë synim zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe vendbanimeve rurale të Kosovës. Arritja e këtij synimi bazohet në realizimin e "Planit të Zhvillimit Bujqësorë dhe Rural 2007 – 2013". Për zbatimin e këtij plani është ngrit një infrastrukturë e qëndrueshme në të cilën janë bashkuar të gjithë njerëzit që duan të merren me bujqësi dhe zhvillim rural. Ne kuadër të kësaj infrastrukture ,një rendësi shume të madhe luajnë grantet dhe subvencionet që operohen

nga MBPZHR përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës por edhe përmes donatorëve të ndryshëm siq është BE,USAIDI dhe donatorë të tjerë.

Zonat rurale të Kosovës për një kohë të gjatë janë përplasur me sfida të mëdha të cilat kanë krijuar pasiguri për sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, gjenerimit të vendeve të reja të punës dhe krijimit të mirëqenies për banorët e tyre. Por për fat të mirë, këto zona kane favore f agro - mjedisore dhe resurse të rëndësishme të cilat janë kusht për zhvillimin rural dhe bujqësor. Këto resurse janë në fokusin e strukturave tona të cilat janë të angazhuara për aktivizimin dhe shfrytëzimin e tyre. MBPZHR-ja gjatë këtyre viteve ka dhënë kontribut të rëndësishëm për zhvillimin rural dhe bujqësor.

3. METODOLOGJIA

Meqë studimi ka të bëjë kryesisht me përfituesit e grandeve për bujqësi dhe zhvillim rural në Masën „Ristrukturimi i potencialit fizik të sektorit agro-rural” në hulumtim është përfshirë Nen-masa Hortikulturë sektori Pemëtari dhe Perimtari në Kosovë, përkrahja për këtë sektor përmes granteve për zhvillim ka filluar që nga viti 2007. Prej asaj kohe e deri me sot numri i përfituesve në këtë sektor ka qenë rreth 400 përfitues (marrë nga lista e përfituesve që gjendet në MBPZHR (Njësia e Pagesave) .

Nga këta përfitues, me metodën e rastit janë zgjedhur si mostër për hulumtim 80 përfitues të këtyre granteve qe i bie që janë 20% të përfituesve. Kjo është një mundësi e mirë për të ardhur deri të e vërteta se si vërtet këto grande kanë ndikuar në përmirësimin e mirëqenies të fermerëve përfitues.

Për grumbullimin e të dhënave është përdor metoda studim në terren, ku të dhënat janë siguruar përmes anketimit, përkatësisht plotësimit të pyetësorit, përmes intervistave të drejtpërdrejta që janë zhvilluar me përfituesit e granteve për zhvillim në sektorin Pemëtari dhe Perimtari.

Paraprakisht është përgatitur një pyetësor, i cili në vetvete ka përfshirë një numër të madh pyetjesh (variablash) përmes së cilave janë marrë

përgjigje të mjaftueshme për të realizuar objektivat dhe nën-objektivat e hulumtimit. I njëjti pyetësor është përdorur për të gjithë përfituesit e granteve të përfshira në këtë hulumtim.

Në mënyrë që të evitohen gabimet e mundshme fillimisht pyetësori është testuar në terren. Për këtë janë bërë tetë intervista testuese në pesë regjionet bujqësore të Kosovës, dhe nga këto intervista testuese janë evidentuar disa mangësi të vogla (pyetje apo alternativa që kanë munguar apo ndonjë pyetje që ka qenë e tepërt). Pas kësaj është kompletuar pyetësori, dhe si elemente të mjaftueshme kanë dale rreth 27 variabla që kanë ndikuar në mënyrë kualitative në hulumtim. Anketimet janë bërë drejtpërdrejt me fermerët përfitues të këtyre granteve, ku anketimi dhe intervistimi është kryer nga vetë

autori i hulumtimit. Kjo mënyrë, ka dhënë mundësinë që përpos përgjigjeve të marra për pyetjet e pyetësorit, gjatë bisedave me fermerët studiuesi ka arritur të mbledh edhe shumë informacione për gjendjen e sektorit të Pemëtarisë dhe Perimtarisë në Kosovë, problemet e fermerëve dhe mendimet e tyre për zhvillimin e këtij sektori në të ardhmen.

Metodat statistikore për realizimin e këtij hulumtimi: së pari është bërë kodimi i pyetësorit dhe është bërë vendosja e të dhënave në programin exell, dhe pastaj është bërë transferimi i të dhënave në programin SPSS. Analizat statistikore mbi variablat përkatëse dhe arritja rezultateve finale të intervistave të marra nga fermerët përfitues të granteve për zhvillim në sektorin Pemëtarisë dhe Perimtarisë janë kryer me SPSS.

Statistikat e Regresionit	
Multiple R	0.346
R Square	0.120
Adjusted R Square	0.033
Standard Error	1.245
Observations	78

ANOVA						
	Df	SS	MS	F	Significance F	
Regression	7	14.954	2.136	1.378	0.228	
Residual	71	110.084	1.550			
Total	78	125.038				
	Coefficients	Standard Error	P-value			
Intercept	1.598	1.789	0.375			
Nr. Anëtarëve të familjes	0.103	0.214	0.631			
Nr. Anëtarëve të punësuar	0.013	0.175	0.941			
Nr. përfitimeve	0.085	0.274	0.758			
Shuma e fituar e financimit	0.374	0.154	0.018			
Përqindja e bashkëfinancimit	0.137	0.213	0.521			
Përqindja e mitjes së buxhetit	-0.549	1.269	0.666			
Mosha e përfituesit	-0.200	0.291	0.494			

4. REZULTATET DHE DISKUTIMET

4.1 Rezultatet

Përmbledhja e analizës së regresionit për rendimentin e arritur të fermerëve si rezultat i faktorëve të hulumtuar, janë dhënë në tabelën 1.

Tabela 1 me të gjitha llojet e vlerësimeve të regresionit, na ka ndihmuar të verifikojmë hipotezën nëse faktorët e përfshirë në analizë kanë ndonjë lidhshmëri me rendimentin e shprehur në kg/ha. Rezultatet e analizës,

përkatësisht koeficientet e regresionit pasqyrojnë se ndryshimi në rendimentin e fermerëve përfitues të grandeve nuk tregoj varshmëri nga faktorët si: Numri i anëtarëve të familjes përfituese, numri i anëtarëve të punësuar në familjet përfituese, numri i përfitimeve, përqindja e bashkëfinancimit, përqindja e rritjes së buxhetit për këtë destinacion dhe mosha e kryefamiljarit përfitues të grantit. Koeficientet e regresionit të faktorëve të sipërcekur sugjerojnë se ndryshimi në rendimentin e fermerëve përfitues shprehur në kg/ha nuk është i rëndësishëm në nivel të rëndësisë 95%. Rezultati përmbledhës tregon se ndikim të rëndësishëm në rendimentin e fermerëve përfitues të grandeve kishte vetëm shuma e financimit shprehur në euro, Vlera e Testit **P-value= 0.018** dhe Koeficienti i **Regresionit 0.374**, tregon për rëndësinë e këtij faktori në rendimentin e arritur nga fermerët. Kështu, rrjedh se për çdo rritje të shumës së financimit shprehur në €, rendimenti mesatar do të rritet për 0.374 kg/ha. Rezultatet e fituara sugjerojnë se ndryshimet në rendimentin e fermerëve shprehur në kg/ha duhet përqendruar në rritjen e mëtejme të financimit direkt të fermerëve, rritjen e shumës së financimit si dhe hulumtimin e kushteve dhe faktorëve të tjerë të cilët potencialisht do të ndihmojnë përmirësimin e ekonomisë së fermerëve në Kosovë.

Si konkludim nga kjo analize kishte me qene që qeveria duhet te beje te gjitha përpjekjet që të rrisë shumat financiare për mbështetje te fermerëve Kosovarë.

4.2 Diskutimi

Qeveria e Kosovës ka treguar përkushtimin e saj për krijimin e parimeve të ekonomisë së qëndrueshme të tregut. Përcaktimi i vendosur për të mbështetur fermerët përmes skemave të qëndrueshme financiare, pasqyron qartë këtë përkushtim. Sikurse u zbulua nga ky studim Qeveria e Kosovës duhet të rrisë ndihmat për fermerët si veprim racional në drejtim të krijimit të favoreve për fermerët e vendit. Fermerët të përfshirë brenda skemave si përfitues tashmë gëzojnë një mbështetje, e cila do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, duke bërë të mundur

që fermerët kosovarë të hyjnë në një treg konkurrues më të përgatitur dhe të organizuar.. Përkrahja direkt e fermerëve tregon se Qeveria e Kosovës ka filluar punën për ndërtimin e mekanizmave për të adresuar sfidat e fermerëve në Kosovë. Prandaj, mbështetja direkte e fermerëve kosovarë ndihmon rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në tregun lokal dhe regjional. Pavarësisht, se efektet e këtij aktiviteti janë ende të limituara në rendimentin e fermerëve, nga viti në vit rezultatet janë më të dukshme. Kjo i arsyeton veprimet e qeverisë nga se fermerët përfitues të ndihmës janë duke u përafua me rendimentet që i arrijnë fermerët në rajon, brenda kulturës së njëjtë.

Pasi Kosova ka kushte të favorshme natyrore për kultivimin e shumë kulturave bujqësore, shtohet si domosdoshmëri vazhdimi i konsolidimit të fermerëve, me qëllim të rritjes së mëtejshme të rendimentit. Për më tepër, ata kanë nevojë krahas rritjes së rendimentit për rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së tyre si fermerë, në mënyrë që të konkurrojnë në mënyrë efektive me prodhuesit e këtyre kulturave në rajon dhe më gjerë. Për të rritur më tej rendimentin e kulturave, fermerët duhet të përmirësojnë procesin e menaxhimit të fermës, duke kursyer shpenzimet në fermë. Për më tepër, për shkak të konkurrencës në rritje, fermerët e Kosovës do të jetë e detyruar që të jenë më inovativ në përdorimin e teknologjive më të sofistikuara. Prandaj, ndihma direkte e filluar viteve të fundit për fermerët është me rëndësi jetike të vazhdohet më tutje. Edhe pse hulumtimi ynë nuk arriti të tregoj se veprimet e marra nga qeveria vitet e fundit kanë dhënë efekte të pritura në rendimentin e fermerëve, ndihmat direkt të fermerëve kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm në ekonominë e tyre. Duhet bërë përpjekje që skema e përfituesve dhe shumat e përfitimit të rriten më tutje, ngjashme siç po ndodhë shumë vite më herët më fermerët e vendeve të rajonit. Së fundi, ndihma direkt e fermerëve në Kosovë siguron të paktën dy përfitime të konsiderueshme të tilla si, rritjen e kapacitetit financiar dhe menaxherial të fermës si dhe një

konkurueshmeri në rritje me fermerët e vendeve të rajonit.

4.3 Përfundim

Studimi ynë tregon se ndikimi i granteve direkt në ekonominë e fermerëve të Kosovës ka qenë pozitivë. Nga të gjithë faktorët e këtij studimi shihet se shumica e përfitimit financiar si e pavarur pasqyron rëndësinë që ka ky faktor në rendimentet e fermerëve kosovarë, në nivelin e rëndësisë 95%, tregon se qasja ndaj këtij faktori duhet mirret në konsideratë me një kujdes të veçantë në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, rezultatet sugjerojnë se ndryshimi në rendimentin e fermerëve pasi ka filluar të aplikohet ndihma direkt, i arsyetojnë mekanizmat e ndërmarrë nga qeveria. Edhe pse kjo analizë nuk argumenton efektet e pritura, i arsyeton plotësisht aktivitetet e ndërmarrja, nga se efektet e regjistruara pasqyrojnë ndryshime pozitive në rendimentin e fermerëve. Kështu, rezultatet e mbështesin pjesërisht hipotezën tonë se grantet direkt kanë pasur një ndikim pozitiv në rendimentin e fermerëve përfitues. Për më tepër, rezultatet e këtij studimi arsyetojnë edhe më shumë përkushtimin dhe ndihmën financiare nga Qeveria e Kosovës për të rritur më tutje rendimentin në fermë.

Gjithashtu, kjo mbështetje financiare i ndihmon edhe më shumë fermerët për përmirësimin e rendimentit dhe rritjen e parametrave të konkurueshmerisë. Një ekonomi fermerësh më efikase, me fitimprurëse do t'ju mundësojë atyre që të rrisin investimet e tyre dhe vlerat e tyre të tregut.

Për më tepër, ky studim i ofron publikut të gjerë me disa arsytimit argumente për ndikimin e granteve direkt në rritjen e rendimentit të fermerëve. Së fundi, studimi konstaton se Qeveria e Kosovës është në rrugën e drejtë, dhe vendimi i saj për të përkrahur fermerët ka qenë një hap i madh drejt rritjes së ekonomisë së fermerëve përfitues nga këto grante qeveritare. Gjithsesi përmirësimet e mëtutjeshme janë të nevojshëm. Duhet theksuar se ekonomia fermerë në Kosovë, në të gjithë sektorët e saj mund të veprojnë në kapacitetin e saj të plotë vetëm në

qoftë së rritet aftësia konkurruese e tyre në tregun lokal dhe rajonal. Mbështetja financiare përmes granteve për zhvillim rural dhe pagesave direkt të jetë e orientuar në zhvillimin e bizneseve ekzistuese, pra modernizimin e tyre dhe krijimin e bizneseve të reja bujqësore dhe rurale, duke ju dhënë përparësi bizneseve të cilat i aplikojnë zbulimet e reja .

Studime të tjera që adresojnë elemente studiuuese në këtë drejtim janë shumë të nevojshëm në të ardhmen

5. LITERATURA

- Adrian, K. 2000, Towards a Theory of the Reform of the Common Agricultural Policy European Integration online Papers (EIoP) Vol. 4 (2000) N° 9; <http://eiop.or.at/eiop/texte/2000-009a.htm>
- Ahner, D. and M. Scheele, 2000, "The Common Agricultural Policy: An overview from where we come, Where we are, Tasks ahead", paper presented at the International Postgraduate Course on "European Agricultural Policy in Transformation", Wageningen University, 15 September 2000.
- Beard, N. and A. Swinbank, 2001, "Decoupled payments to facilitate CAP reform", *Food Policy* 26 (2001): 121-145.
- Brenton P. and Nunez Ferrer, J. 2000, "EU Agriculture, the WTO and Enlargement", in Bilal S. and Pezaros P. (Ed.) *Negotiating the Future of Agricultural Policies: Agricultural Trade and the Millennium*, Kluwer Laë International. pp. 113-131.
- Canali, G. 2005, Common agricultural policy reform and its effects on sheep and goat market and rare breeds conservation, Università Cattolica, Istituto di Economia Agro-alimentare, via Emilia Parmense 84, 29100, Piacenza, Italy
- Fischler, F., 2001, "The road ahead for EU agricultural and rural policy", Paper presented at the
- Fischler, F. 2001, "Europe's Agricultural Policy Must Satisfy New Consumer Demands" *Financial Times*, 9 May 2001.
- Fischler, F. 2001, "EU and US Farm Policies. Where do they differ and where do they

converge?”, paper presented at the US congressional dinner, Washington, D.C., 17 May.

Fischer, F. 2003. Reframing Public Policy:

Discursive Politics and Deliberative Practices.

New York: Oxford.

Grandet për bujqësi dhe zhvillim rural MBPZHR
2009

Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2009-2013,
MBPZHR, Prishtinë, 2009

Swinnen, Johan F.M. 2001, A Fischler Reform of
the Common Agricultural Policy? CEPS Working
Document No. 173, [Working Paper].